

VENDIM
Nr. 307, datë 29.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1056, DATË 14.12.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘BY-PASS FIER’”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘By-pass Fier’”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për “tokë bujqësore”, me sipërfaqe 837 335.03 (tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e pesë pikë zero tre) m², me vlerë 400 103 448.1 (katërqind milionë e njëqind e tre mijë e katërqind e dyzet e tetë pikë një) lekë, për “tokë truall”, me sipërfaqe 170 (njëqind e shtatëdhjetë) m², me vlerë 406 300 (katërqind e gjashtë mijë e treqind) lekë, si dhe objekte, me vlerë 16 282 001 (gjashtëmbëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e një) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 416 791 749.4 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë pikë katër) lekësh.

...
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 416 791 749.4 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë pikë katër) lekësh përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.”.

2. Të dhënat për shpronësim të numrit rendor 26, të tabelës bashkëlidhur vendimit nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të emërtuar “Lista e pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës “Fier–Vlorë”, segmenti Fier – By-pass Levan”, zëvendësohen me të dhënat me të njëjtin numër rendor të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në fund të tabelave bashkëlidhur vendimit nr. 1056, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

II. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Albana Koçiu

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 1056, DATË 14.12.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE. OË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘BY-PASS-FIER’”. TË NDRYSHUAR

Pronari				Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Vlerësimi për shpronësim			Adresat	Shënime
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Të dhënat e pasurisë				Tokë “arë”				
				ZK	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. total e (m²)	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera totale (lekë)		
26	Bedrije	Pasho	Mehmetaj	2636	128/25	Ullisht e	900	730	437	319,010	Mbrostar-Ura	
	Shaqe	Latif	Agalliu									
	Bekdash	Pasho	Veliu									
	Nexhmije	Pasho	Guri									
	Valentina	Pasho	Jermini									
	Shkelqim	Pasho	Veliu									
1	Selim Musa Veliu			2636	73/14	Arë	11564	846	437	369,702	Mbrostar-Ura	
2	Nesti	Zogu	Profka	3436	58/80	Arë	1320	1137	299	339,963	Shtyllas	
3	Nasi	Todi	Zhezha	3980	4/1	Arë	2220	1532	684	1,047,888	Mbrostar-Ferko	
4	Refat	Jonuz	Braka	2436	121/36	Arë	7980	793	335	265,655	Fier	
Shuma totale								4106.2		2,342,218		
Efekti financiar shtesë 1.935.021.4 lekë												